VENDIM
Nr. 258, datë 6.4.2016

PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2016, MIRATUAR PËR AGJENCINË E KËRKIMIT TË TEKNOLOGJISË DHE INOVACIONIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 dhe 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar dhe të nenit 13, të ligjit nr. 147/2015, "Për buxhetin e vitit 2016", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në buxhetin e miratuar për vitin 2016, në programin "Shërbime për teknologjinë dhe inovacionin", të grupit buxhetor "Institucione të tjera qeveritare", zëri "Shpenzime korrente", të shtohet fondi prej 11 620 000 (njëmbëdhjetë milionë e gjashtëqind e njëzet mijë) lekësh, për Agjencinë e Kërkimit të Teknologjisë dhe Inovacionit, i cili të përdoret për mbulimin e shpenzimeve për mbylljen e veprimtarisë financiare dhe administrative të AKTI-t.

2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2016.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Agjencia e Kërkimit të Teknologjisë dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi